

Nr. _____ Prot.,

Tiranë më ____ . ____ .2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE TË VEÇANTA PËR PRANIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Shërbim për infrastrukturë të dedikuar optike (FIBËR L2 dhe internet)”.

LLOJI I PROCEDURES: Procedurë e Hapur e Thjeshtuar

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

32412120-1 Rrjeti intranet; 72400000-4 Shërbimet e internetit

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,936,774 (shtatë milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Shërbimeve të Integruara të Sterilizimit” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

***Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, nenit 30 “Sigurimi i ofertës”, pika 1, të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilat parashikohet se:*

- Neni 82, i LPP-së, pika 1: *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet nën rregullat e prokurimit publik*”.

- Neni 83 i LPP-së: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*;

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë/Autorizim të përgjithshëm nga AKEP për të gjitha shërbimet e kërkuara në këtë procedurë.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 41, pika 4/a, të Vendimit nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, për të vërtetuar mundësimin e shërbimit nga një kompani e licensuar dhe AKEP-i është i vetmi institucion zyrtar që lëshon këto autorizime për operatorët ekonomik në fushën e telekomunikacionit.

2.1.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Çertifikatë me standardet ISO 9001:2015, ose e përditesuar për Menaxhimin e Cilësisë, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit, e vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 41, pika 4/a, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar, në Rekomandimin e Përbashkët të APP-së me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018, “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”, si dhe në Rekomandimin të APP-së, nr. 8197 prot, datë 03.09.2018, “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit per mallra, shërbime apo pune”, për të siguruar shërbime të cilat janë në pajtueshmëri me sistemin e menaxhimit të cilësisë.

2.1.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Çertifikatë të vlefshme ISO 20000-1:2018 ose e përditësuar për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit. Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit.

Argumentimi: *Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kjo kërkesë bazohet në Nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 dhe Nenin 41 të VKM nr. 285/2021. Duke qenë se objekti i kontratës është "Shërbim IT" për një infrastrukturë kritike kombëtare (Sistemi i Gjurmueshmërisë dhe Sterilizimit), Autoriteti Kontraktor kërkon që Operatori Ekonomik të dëshmojë se zbaton standartet ndërkombëtare për Menaxhimin e Shërbimeve IT.*

2.1.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë çertifikatë të vlefshme me standartet ISO 22301:2019 ose e përditësuar për Sistemin e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit (Business Continuity Management System). Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: *Duke qenë se ky shërbim shtrihet në 13 lokacione gjeografike të ndryshme, të cilat përpunojnë të dhëna dhe shërbime në kohë reale, vazhdimësia e shërbimit është kritike për mbarëvajtjen e punës së Autoritetit Kontraktor. Kjo kërkesë bazohet në nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", me qëllim që Operatori Ekonomik të dëshmojë se zotëron plane operative dhe procedura të certifikuar për rimëkëmbjen nga incidentet madhore (Disaster Recovery). ISO 22301 garanton që OE ka kapacitete organizative për të ruajtur vazhdimësinë e rrjetit Intranet/Internet dhe për të minimizuar kohën e ndërprerjes së shërbimit në rast dështimesh teknike apo emergjencave të tjera, duke mbrojtur interesat e institucionit.*

2.1.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesi Çertifikatë me standartet ISO 27001:2022 ose e përditësuar për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në emër të ofertuesit, e vlefshme.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, në nenin 41, pika 4/a, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar, në Rekomandimin e Përbashkët të APP-së me Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, datë 20.03.2018, "Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë", si dhe në Rekomandimin të APP-së, nr. 8197 prot, datë 03.09.2018, "Mbi hartimin e kriterëve*

për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime apo punë", për të siguruar shërbime të cilat janë në pajtueshmëri me menaxhimin e sigurisë së informacionit, pasi duhet të kemi parasysh kriteret e sigurisë nëpër të cilin do të kalojë i gjithë informacimi).

2.1.6 Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 2 (dy) lidhje ndërkombëtare për shërbimin e Internetit. Për të vërtetuar këtë pikë, Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kopje të kontratës/marrëveshjes ose dokument alternativ, me subjektet jashtë territorit të Shqipërisë mbi përdorimin e Aksesit Global në Internet.

Argumentimi: *Kërkesa për dy lidhje ndërkombëtare të pavarura dhe mbrojtje aktive ndaj sulmeve DDoS bazohet në:*

- 1. Ligjin Nr. 2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike", neni i detyrimeve për infrastrukturën e rëndësishme të informacionit.*
- 2. Ligjin Nr. 9918/2008 "Për Komunikimet Elektronike", neni 101/1 për Integritetin e Rrjetit.*
- 3. Rregulloret e AKEP mbi masat minimale të sigurisë teknike për mbrojtjen nga sulmet volumetrike (DDoS).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.**

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin Neni 41 "Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve" dhe pikën 1 të nenit 43 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se: "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve"... "Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare".*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31

mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit limit të Marrëveshjes Kuadër, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre vjetëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre vjetëve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% e fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 41, pika 3 të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar). Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik për zbatimin e kontratës duhet të ketë të punësuar në stafin e tij jo më pak se 6 (gjashtë) inxhinier të diplomuar në fushën e telekomunikacionit dhe/ose Elektrike dhe/ose Elektronike dhe/ose Teknologji informacioni që do të kryejnë shërbimin e konfigurimit dhe instalimit të shërbimit. Inxhinieret duhet të kenë certifikimet si më poshtë:

- Të paktën 2 (dy) Inxhinier të paisur me Certifikatë (MTCRE) MikroTik Routing ose ekuivalent.
- Të paktën 3(tre) Inxhinier të paisur me Certifikatë (MTCNA) ose ekuivalent.
- Të paktën 1(një) Inxhinier të certifikuar për IT Infrastruktura Service Management ITIL

Për këta punonjës duhet të paraqitet:

- Diplomë përkatëse
- Kontratë pune e vlefshme
- Certifikatat perkatese.

Argumentim: *Operatori ekonomik duhet të tregojë që zotëron të gjithë kapacitetet e nevojshme për zbatimin e kësaj kontrate. Një operator ekonomik të merret në konsideratë duhet të paktën të ketë 6 (gjashtë) punonjës të diplomuar në fushat e sipërpërmendura. Personeli i mësipërm (Inxhinierët e Kërkuar) duhet të kenë marrëdhënie pune me ofertuesin për një periudhë jo më pak se 3 (tre) muaj, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig të listpagesave për 3 muajt e fundit. Kërkesa e mësipërme është kusht pasi pajisjet fundore të routim-it të Autoritetit Kontraktor janë Mikrotik cka e bën të domosdoshme nevojën për inxhinierë të kualifikuar me certifikimin e mësipërm për zbatimin e kësaj kontrate për këto pajisje qëndrore.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të zotërojë një infrastrukturë të vetën me fibër optike, ose në rast se operatori nuk disponon një infrastrukturë të vetën me fibër optike për të gjithë pikat e kërkuara në këto specifikime, atëherë operatori duhet të paraqesë kontratë qiraje/marrëveshje bashkëpunimi me një operator të licensuar nga AKEP-i. Kjo kontratë e qirasë/marrëveshje bashkëpunimi, në rastin e marrjes së këtij shërbimi, duhet të dokumentohet për ofrimin e shërbimit në pikat fundore sipas specifikimeve teknike të procedurës.

- Për të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim/Çertifikatë/Autorizim nga AKEP-i, se operatori ka shtrirje me fibër optike në pronësi të tij për ofrimin e aksesit të internetit dhe transmetim të dhënash sipas tabelës së lokacioneve në DST e dokumentave të tenderit.

- Në rastin e kontratës me qira/marrëveshje bashkëpunimi, operatori ekonomik paraqet Vërtetim/Çertifikatë/Autorizim nga AKEP-i, në emër të operatorit qiradhënës/bashkëpunues, për

ofrimin e aksesit të internetit dhe transmetim të dhënash në qytetin/qytetet sipas tabelës së lokacioneve në DST.

Argumentim: Ky kriter është vendosur për të garantuar se Operatori Ekonomik disponon kapacitetet teknike reale për të ofruar shërbimin në të gjitha pikat gjeografike të kërkuara, në përputhje me Nenin 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Përmes këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor sigurohet që shërbimi do të ofrohet përmes një infrastrukture të qëndrueshme (Fibër Optike), e certifikuar nga AKEP sipas detyrimeve të Ligjit Nr. 9918/2008 “Për Komunikimet Elektronike”.

Ky kërkesë është e domosdoshme për të garantuar Integritetin e Rrjetit dhe Disponueshmërinë e shërbimit, duke eliminuar rreziqet e ndërprerjes nga mungesa e asetëve rrjetore, konflikteve të pronësisë mbi infrastrukturën passive, apo sulmet DDoS, siç kërkohet nga Ligji Nr. 2/2017 'Për Sigurinë Kibernetike'. Sigurimi i infrastrukturës fizike (pronësi ose qira e licencuar) është i vetmi mjet që garanton konfidencialitetin e të dhënave dhe eliminon 'pikën e vetme të dështimit', duke përmbushur kështu standardet e sigurisë kombëtare për mbrojtjen e infrastrukturave kritike siç është në këtë rast Autoriteti Kontraktor OSHIS Sha.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Zgjidhjen e detajuar teknike sipas indikatorit të cilësisë të përshkruar në specifikimet teknike per kete procedure prokurimi.
- Bllok-skemën totale të sistemit për zgjidhjen e ofruar dhe teknologjinë që ai përdor.
- Zgjidhje të detajuar të ofrimit të shërbimit me fibrën optike në pronësi të tij ose të marrë me qera.
- Zgjidhjen e detajuar me skemë logjike dhe kontratat përkatëse për ofrimin e shërbimit të mbrojtjes DDOS duke treguar qartësisht edhe scrubing center ku operatori do të drejtojë trafikun në rast sulmesh.

Argumentim: Kjo kërkesë është një mekanizëm kontrolli për të garantuar se Operatori Ekonomik jo vetëm ofron lidhje interneti, por ofron një **ekosistem të sigurt** për transmetimin e informacioneve sensitive të gjurmueshmërisë kirurgjikale. Detajimi i skemave dhe mbrojtjes DDoS është i domosdoshëm për të parandaluar rrjedhjen e të dhënave dhe për të garantuar që çdo rekord mbi sterilizimin e instrumenteve mbetet i paprekshëm, i disponueshëm dhe konfidencial, duke mbrojtur kështu interesat e OSHIS-it dhe sigurinë e të dhënave të pacientëve.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për përmbushjen e të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 8 e nenit 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në

varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke ofruar shërbimin e kërkuar.

Të gjithë dokumentet duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me nenin 36 “*Specifikimet teknike*” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 41 “*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*” të Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT

Adresa: Tiranë, Kashar, Mëzez, Autostrada Tiranë-Durrës, Km.5

Web: <https://oshis.al> Email: info@oshis.al